



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.47/2 prot

Datë 12.01.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË DUKE
REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT NGRIHEN PRETENDIME.

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Filo Gas” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-12739-11-24-2021, me objekt “23. Oxygen Gaz për përdorim mjeksor, i lëngshëm x 100% Litra”, me fond limit 10,888,560 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28-12-2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues: “Messer Albagaz”
Autostrada Tiranë-Durrës, km.45, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar i Traumës
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “Filo Gas” SHPK
Korcë Bulgarec, Rruga Korçë-Bilisht, Km. i 2, objekt privat.

Në datën 12.01.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.47 e operatorit ekonomik “Messer Albagaz” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-12739-11-24-2021, me objekt “23. Oxygen Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem x 100% Litra”, me fond limit 10,888,560 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28-12-2021, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Filo Gas” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: **c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik “Messer Albagaz” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesmarrës në procedurë “Filo Gas” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Filo Gas” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

Pika 2.3 “Kapaciteti teknik” i kriterëve të vecanta të kualifikimit.

- Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:
- Furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e këtij loti (me përdorim në sektorin shëndetësor) në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave të këtij loti, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik” i kriterëve të vecanta të kualifikimit.

- Operatori ekonomik duhet të provojë se nëse shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë 1 (një) tanker me kapacitet minimumi 10.000 litra per t’u instaluar në ambjentet e SUT. Per periudhen e zgjatjes se punimeve, kontraktori duhet te marrë masat për të mos ndërprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore. OE ka detyrimin per certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes se inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore. OE duhet te provojë se siguron, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për të siguruar gadishmerine e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kësaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.

- Ne rastin kur OE i ka në pronesi, duhet te paraqese nje deshmi per pronesine mbi keto tankera (fature blerje ose dokument doganor per importimin e tankerave te oksigjenit ose cdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vertetimin e leshuar, jo me pare se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga organet kompetente kombëtare për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit ne fuqi, ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.
- Ne rast se tankerat e oksigjenit do te merren me qira, duhet te paraqitet kontrata ose marrveshja paraprake e qirase, shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronesine e pronarit te tankerave te oksigjenit si dhe Vertetimin e leshuar, jo me pare se 6 muaj nga data e hapjes se ofertave, nga organet kompetente kombëtare për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit ne fuqi, ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.
- Shenim: Gjatë periudhës nga nenshkrimi i kontrates deri në instalimin e tankerave, Operatori i suksesshem duhet të furnizojë AK perfitues me bombula oksigjeni mjeksor te gazte i cili do te konvertohet me sasine e Oksigjeni mjeksor të lëngët. Oksigjeni mjeksor gaz i përdorur në bombula duhet të jetë i regjistruar sipas pikës 4.
- Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 12.01.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri